



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 143, datë 22.04.2020**

**PËR  
RIFILLIMIN E VEPRIMTARISË DHE SHËRBIMEVE GJYQËSORE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 147/1 dhe 147/a, pika 1, shkronjat “d” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Ligjin nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.03.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, në respektim të Aktit Normativ nr.9, datë 25.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, si dhe në konsideratë të Vendimeve të tij nr.127, datë 10.03.2020, nr.128, datë 24.03.2020 dhe nr.133, datë 06.04.2020, lidhur me pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga Covid-19,

**VENDOSI:**

1. Rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë, më datë 27.04.2020.
2. Ngarkohen këshillat dhe kryetarët në detyrë të gjykatave për marrjen e masave për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore gjyqësore, në përputhje dhe respektim të masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**